

Mesazhet kryesore për infermierët

Detyrat

1. Ju jeni në një pozicion kyç për të përmirësuar përdorimin e antibiotikëve, duke bashkëpunuar me ekipin e Kujdestarisë së Antibiotikëve (administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve) [96].
2. Detyrat tuaja lidhur me përmirësimin e përdorimit të antibiotikëve përfshijnë [31,96,97] [konsensusi i ekspertëve]:
 - a) Administrimin e antibiotikëve të pacientët sipas recetës së përshkruar nga mjeku;
 - b) Koordinimin e marrjes dhe dërgimit të mostrave mikrobiologjike, si edhe raportimin e tyre të mjekët;
 - c) Raportimin e efekteve të padëshirueshme të terapisë me antibiotikë të mjekët dhe komisionet kompetente të kontrollit;
 - d) Lehtësimin e komunikimit midis mjekëve, barnatores, laboratorit, planifikuesve të lëshimit të pacientëve, konsulentëve dhe pacientëve;
 - e) Njoftimin e pacientëve dhe familjarëve të tyre për trajtimet aktuale;
 - f) Monitorimin e statusit të pacientit 24 orë në ditë; dhe
 - g) Menaxhimin e rezervave të antibiotikëve në repartin tuaj, duke siguruar njëkohësisht gjurmueshmërinë e përdorimit të antibiotikëve [konsensusi i ekspertëve].

Çka mund të bëni dhe si mund të bashkëpunoni?

3. Përmirësoni praktikat e administrimit të antibiotikëve në bashkëpunim me mjekët dhe farmacistët [96,97].
4. Zbatoni masat e parandalimit dhe kontrollit të infeksioneve që janë caktuar në institucionin tuaj [konsensusi i ekspertëve].
5. Sigurohuni që pacientët (dhe familjet e tyre) të kuptojnë arsyet e terapisë me antibiotikë dhe këshillat kryesore që lidhen me përdorimin e antibiotikëve, duke përfshirë [31,69] [konsensusin e ekspertëve]:
 - e) Të marrin antibiotikët saktësisht siç përshkruhet nga mjeku;
 - f) Të mos ruajnë kurrë antibiotikë për përdorim të mëvonshëm;
 - g) Të mos përdorin kurrë antibiotikë të mbetur nga trajtime të mëparshme; dhe
 - h) Të mos shpërndajnë kurrë antibiotikë të mbetur me njerëz të tjerë.
6. Sigurohuni që mostrat klinike të merren në mënyrë korrekte dhe të dërgohen në laboratorin e mikrobiologjisë, para se të filloni trajtimin me antibiotikë [31,42,70].
7. Sigurohuni që rezultatet laboratorike t'i komunikohen menjëherë mjekut kurues [konsensusi i ekspertëve].

8. Nxisni mjekët që të dokumentojnë vendimin e tyre të rishikimit të terapisë për të gjithë pacientët me antibiotikë pas 48-72 orësh [31,42,69].
9. Informoni mjekun ose farmacistin nëse shihni se një pacient ka një recetë me antibiotikë, e cila vazhdon për më shumë se shtatë ditë pa një kohëzgjatje të specifikuar [69].
10. Nëse shihni anëtarë të stafit në spital ose në mjediset e kujdesit shëndetësor që shkelin udhëzimet ose protokollet, pyetini pse po e bëjnë këtë dhe sigurojuni mjete për të kuptuar se çfarë po bëjnë gabim [69] [konsensusi i ekspertëve].
11. Merrni pjesë rregullisht në kurse trajnimi dhe takime mbi përdorimin e kujdesshëm të antibiotikëve, mbledhjen e mostrave dhe parandalimin e kontrollin e infeksioneve [53,96].